



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



RRJETËZIM
PËR ZHVILLIMIN RURAL
ME PJESËMARRJE



ANRD
ALBANIAN NETWORK FOR RURAL DEVELOPMENT
RRJETI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN RURAL

LETËR POZICIONIMI

mbi
Qeverisjen e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Janar 2019

SQARIM

Ky publikim u bë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim





Përmbledhje Ekzekutive

Bujqësia dhe zhvillimi rural kanë rëndësi ekonomike dhe demografike për Shqipërinë. Përkundër relevancës së lartë të sektorit, kontributi i të cilit në ekonominë kombëtare është më i lartë krahasuar me vendet e Europës Juglindore (EJL) dhe ato anëtare të Bashkimit European (BE), ai ende nuk ka mundur të jetë prioriteti i lartë në politikat kombëtare. Pavarësisht dinamikës së viteve të fundit, politikat kombëtare për zhvillimin bujqësor dhe rural nuk kanë prezantuar instrumente efektiv, që reflektojnë dhe adresojnë problematikat dhe sfidat zhvillimore me të cilat përballen komunitetet rurale. Ato karakterizohen nga paqëndrueshmëri dhe mbështetje buxhetore relativisht e ulët, e cila është më e ulëta në rajon. Për shkak të mungesës së studimeve ndikimi i tyre në efikasitet është i panjohur.

Proceset reformuese në sektor përballen me mungesën e theksuar të kapaciteteve administrative dhe institucionale. Ato duhet të udhëhiqen nga parimet integruese europiane dhe kërkojnë përgjegjshmëri të lartë të institucioneve publike në këtë proces të ngadaltë transformimi. Politikat kombëtare tregojnë mangësi serioze në lidhje me pajtueshmërinë me Politikën e Përbashkët Bujqësore (PPB) të BE-së dhe parimet e saj siç është mosdiskriminimi, drejtësia dhe barazia nuk reflektohen në instrumentet e mbështetjes publike për sektorin.

Politikat dhe instrumentet për zhvillimin bujqësor dhe rural nuk janë efektive për të adresuar sfidat me të cilat përballen zonat rurale. Hartimi i politikave pa pjesëmarrje, të pa mbështetura në evidenca, të mbetura peng i agjendave politike, pa i shërbyer një vizioni afatgjatë të sektorit janë disa nga shkaqet kryesore. Politikat sado aktive të viteve të fundit, janë të shkëputura nga nevojat reale dhe interesat e fermerëve dhe si të tilla gjenerojnë rezultate afat-shkurta në ekonominë dhe cilësinë e jetës në zonat rurale.

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD) synon të kontribuojë në zhvillimin e komuniteteve rurale duke marrë një rol aktiv në proceset dhe reformat në bujqësi dhe zhvillimin rural. Përpjekjet e derimëtanishme kanë reflektuar gatishmërinë për të mbështetur dhe kontribuar në zbatimin me sukses të politikave dhe instrumenteve të zhvillimit rural. Në këtë kontekst, ANRD ka nxitur ndërtimin e një agjende aktive, gjithëpërfshirëse dhe me dy kahe të zhvillimit rural në vend. Në vijim të këtij angazhimi, ANRD ka përgatitur këtë **Letër Pozicionimi mbi Qeverisjen e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural** me inputet e një sipërmarrje konsultimi mbarëkombëtarë.


Letra e Pozicionimit synon të trajtojë problematikat dhe mangësitë kryesore të kuadrit kombëtar të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural dhe të ofrojë rekomandime për adresimin e barrierave që pengojnë instrumentet mbështetës të sektorit të jenë efektive për të dhënë rezultate konkrete dhe të qëndrueshme në kohë. Për këtë, kjo letër pozicionimi sjell një perspektivë kritike të qeverisjes së sektorit me qëllimin për të përmirësuar qasjet dhe metodologjinë e hartimit, rishikimit dhe zbatimit

të politikave kombëtare të zhvillimit bujqësor dhe rural në frymën e PBB-së. Në këtë kontekst, procesi konsultues u realizua i udhëhequr nga parimet e instrumentit të politikës së BE për zhvillimin rural - Zhvillimit Vendor të Udhëhequr nga Komuniteti (CLLD) - si një formë e re e zhvillimit të zonave rurale dhe demokracisë me pjesëmarrje.

Procesi konsultues u nxit nga shqetësimet e fermerëve dhe sipërmarrësve rural rreth sfidave të shumta që ndeshin për të siguruar ndihmë dhe mbështetje komplementare publike të aktiviteteve të tyre ekonomike. Takimet konsultuese me forumet rajonale të Drinit, Arbërit, Egnatias dhe Vjosës u zhvilluan përgjatë muajit Nëntor 2018. Tetë takime konsultuese sollën së bashku rreth 250 pjesëmarrës, të cilët përfaqësojnë fermerë, organizata të shoqërisë civile, autoritete lokale, duke përfshirë bashkitë dhe këshillat e qarqeve, drejtoritë e bujqësisë, universitetet dhe sipërmarrës në agroturizëm, bujqësi, bimë medicinale, blegtori, bletari etj.

Procesi konsultues dhe Letra e Pozicionimit përfaqëson një përpjekje me synimin:

- Për t'u ardhur në ndihmë aktorëve në nivel vendor duke artikuluar nevojat, interesat dhe prioritetet e tyre për zhvillimin e komuniteteve rurale dhe për të advokuar për politika bujqësore dhe të zhvillimit rural të lidhura ngushtë me to;
- Për t'i ardhur në ndihmë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për të hartuar politika dhe instrumente mbështetëse të bujqësisë dhe zhvillimit rural që reflektojnë interesat dhe prioritetet e komuniteteve rurale të mbështetura së pari në konsultim të gjerë me grupet e interesit;
- Për t'u ardhur në ndihmë institucioneve të tjera kombëtare dhe ndihmës së huaj në sektor për të përmirësuar efektshmërinë e kontributit të tyre dhe ndikimit të programeve në bujqësi dhe zhvillim rural.



Konteksti sektorial në Shqipëri në një perspektivë krahasuese me vendet e BE- së dhe ato në rajon

Pavarësisht potencialit të konsiderueshëm të bujqësisë dhe zonave rurale në Shqipëri, ende sektori karakterizohet nga sfida të shumta. Njëkohësisht, ekzistojnë mundësi për zhvillimin e mëtejshëm të tij, të cilat lidhen më së shumti me proceset integruese të vendit. Zhvillimi i bujqësisë dhe ekonomisë rurale ka qenë një çështje e rëndësishme e politikës së viteve të fundit. Promovimi i risive në skemën kombëtare mbështetëse dhe modeleve zhvillimore të Programit të 100 fshatrave përgjithësisht injektuan një ndjenjë optimizmi në publikun e gjerë dhe në veçanti në banorët e komuniteteve rurale. Për më tepër, edhe Programi IPARD II çeli thirrjet e para për projekte.

Në dekadat e fundit zonat rurale të vendit tonë kanë përjetuar probleme të mprehta të tilla si: shpopullimi në masë të konsiderueshme, shërbime publike jo-adekuate, akses i ulët në shërbime publike dhe tregje, infrastrukturë publike e pamjaftueshme etj. Pavarësisht modeleve pozitive në zhvillimin rural të sipërmarrjeve familjare, ende largimi nga zonat rurale drejt atyre urbane është realitet; emigrimi mbetet një rrugëzgjdhje e detyruar dhe jo një zgjedhje e popullatës; bujqësia përfaqëson një sektor jo tërheqës, ndërsa reforma administrative territoriale ka gjeneruar sfida të reja për popullatën rurale. Shumë zona rurale janë përfshirë në një proces që në mënyrë të pakthyeshme po i shndërron në nocione thjesht gjeografike.

Bujqësia dhe zhvillimi rural kanë rëndësi jo vetëm ekonomike por edhe demografike për Shqipërinë. Në vitin 2017, përqindja e vlerës së shtuar bruto (VSHB) që gjenerohet nga sektorët e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit ishte 22.1%¹; punësimi në sektor si përqindje ndaj punësimit total llogaritet në 38.2%² dhe 40.7% e popullsisë jeton në zonat rurale³. Dy treguesit e fundit, punësimi dhe popullsia, kanë pësuar rënie graduale ndër vite. Për shembull mesatarja e punësimit në sektor në periudhën 2005-2007 ka qenë 57.9%. Të tillë tregues konfirmojnë relevancën e sektorit si në ekonominë kombëtare ashtu edhe në aspektin demografik.

Rëndësia e sektorit në Shqipëri arrin treguesit më të lartë krahasuar jo vetëm me vendet e EJL, por edhe me vendet anëtarë të BE-së (27 vende). Për shembull, në vitin 2012, VSHB e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit ndaj VSHB kombëtare për Shqipërinë ishte më e larta (21.3%) krahasuar me mesataren e vendeve të BE-së (1.7%) si dhe me atë të vendeve të Europës juglindore (EJL) (5%- 14%).⁴ E njëjta gjë mund të thuhet edhe për punësimin në bujqësi, pyjtari dhe peshkim, që në Shqipëri arrin në 55%. Ky është treguesi më i lartë krahasuar me vendet e EJL (17-24%) dhe shumë më i lartë krahasuar me mesataren në vendet e BE-së (5%).⁵

1 Baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (2017). Aksesuar në <http://app.seerural.org/agricultural-statistics/> (Dhjetor 2018)

2 Po aty.

3 <http://www.fao.org/faostat/en/#country/3>


4 Volk, T., Erjavec, E., Mortensen, K. (2014) Politika Bujqësore dhe Integrimi European në Europën Juglindore. Organizata Botërore e Ushqimit dhe Bujqësisë.

5 Po aty

Megjithatë, pavarësisht kontributit të konsiderueshëm të sektorit në ekonominë e vendit, politikat bujqësore dhe të zhvillimit rural nuk kanë mundur të jenë prioritet i lartë për Shqipërinë. Shqipëria shënon vlerën më të ulët në mbështetjen buxhetore për bujqësinë dhe zhvillimin rural në krahasim me vendet e EJT dhe ato të BE-27. Mesatarja e mbështetjes vjetore në dekadën e fundit ka qenë përafërsisht 25 milionë Euro ose rreth 1.4% e VSHB së sektorit⁶. Mbështetja buxhetore për hektar të sipërfaqe bujqësore e shfrytëzuar (SBSH) në Shqipëri për të njëjtën periudhë është 25 Euro për Ha, ndërsa në rajon këto vlera luhaten ndërmjet vlerës minimale 60 Euro në Bosnje Hercegovinë deri në 150 Euro në IRJ Maqedoni⁷. Këto vlera tregojnë qartë që sektori i bujqësisë dhe zhvillimit rural, përkundër rëndësisë së madhe në ekonominë e vendit, ka mbështetje buxhetore shumë të ulët. Perspektiva krahasuese me vendet e rajonit dhe ato të BE-së konfirmon zëshëm mbështetjen e papërfillshme buxhetore, e cila nuk mundet të adresojë çështjet kritike të sektorit dhe ta bëjë bujqësinë një sektor tërheqës për popullatën.

6 Zhllima, E., Zhvillimi i politikave shqiptare të bujqësisë dhe pajtueshmëria me Politikën e Përbashkët Europiane, në Rama, K., Zhllima, E., Imami, D, 2018, Sfidat e Shqipërisë për Zbatimin e Politikave Agro-Mjedisore në kuadër të Integritimit në BE, Botim i EU Policy Hub

7 Po aty.



Qeverisja e bujqësisë dhe zhvillimit rural në Shqipëri

- Zëra nga forumet e Arbërit, Drinit, Egnatias dhe Vjosës

Cila është perspektiva e fermerëve dhe sipërmarrësve ruralë në lidhje me skemën kombëtare për mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural? Po në lidhje me programin e 100 fshatrave, IPARD II? Cilat janë çështjet problematike që kërkojnë vëmendje për të pasur politika dhe instrumente më efektive? Cilat janë përvojat, perceptimet dhe mësimet e nxjerra?

Mbështetja buxhetore për bujqësinë dhe zhvillimin rural përfaqëson një instrument mbështetës kryesor për fermerët dhe sipërmarrësit rural. Përkundër kësaj, evidencat tregojnë se **niveli i mbështetjes buxhetore**, pavarësisht trendeve të lehta rritëse, edhe pse të paqëndrueshme ndër vite, është tepër i ulët. Pagesat direkte të fermerëve janë minimale dhe nuk ndikojnë rritjen e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë. Mbështetja buxhetore për bujqësinë, specifikisht masat mbështetëse direkte për prodhimin, janë të papërfillshme për një sektor të një rëndësie të konsiderueshme në ekonominë kombëtare.

Politikat e bujqësisë dhe zhvillimit rural janë karakterizuar nga luhatshmëri e madhe si në strukturën e mbështetjes buxhetore ashtu edhe në numrin e masave, të përmbajtjes dhe kriterëve. Ndër vite janë zbatuar një numër i kufizuar i skemave të mbështetjes direkte, në një kohë kur disa prej tyre janë zbatuar vetëm për 1 ose 2 vjet.⁸ Skema kombëtare e bujqësisë dhe zhvillimit rural në vitin 2018 propozoi 52 masa mbështetëse nga 17 të tilla në vitin 2017⁹. Një paqëndrueshmëri e tillë sjellë keqpërdorim të burimeve administrative, mungesë orientimi dhe pasiguri të fermerët dhe sipërmarrësit rural, duke rezultuar në investime që nuk i shërbejnë vizionit afatgjatë të zhvillimeve të sektorit.

Politikat e sektorit nuk bazohen në një logjikë zhvilluese që të kontribuojnë në zhvillimin koheziv të vendit, pra të reduktimit të pabarazive zhvillimore territoriale. Instrumentet e mbështetjes të sektorit nuk janë të përshtatura me specifikat e territoreve të ndryshme rurale dhe si të tilla ato nuk adresojnë problemet zhvillimore. Nuk ka masa mbështetëse specifike për territore specifike. Ndër vite, një numër i caktuar fermerësh në zona specifike janë përfitues të vazhdueshëm të mbështetjes buxhetore dhe mungojnë fermerë përfitues në zona të tjera të vendit. Përkundër krijimit të 'ishujve të zhvillimit', hartimi dhe zbatimi i politikave publike duhet të dëshmojnë rishpërndarje për zhvillim koheziv.

Politikat kombëtare të zhvillimit rural dhe bujqësor ende nuk adresojnë problemet e fragmentarizimit të lartë të tokës bujqësore dhe mbizotërimit të fermave të vogla. Për rrjedhojë, shumica e fermerëve ndjehen të përjashtuar nga skemat e mbështetjes. Kriteret e pagesave direkte nuk përputhen me frymën e PBB; ato nuk trajtojnë

8 Zhllima, E., and Gjeci, në Volk, T., Rednak, M., Erjavec, E., Zhllima, E., Gjeci, G., Bajramovic, S., & Gjokaj, E. (2017). Monitorimi i zhvillimeve të politikave bujqësore në Ballkanin Perëndimor, Komisioni Europian, Qendra e Bashkuar e Kërkimit.


9 Agjensia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural. Skemat Kombëtare të mbështetjes aksesuar në <http://azhbr.gov.al/financim/skemat-kombetare/>

kufizimet më të cilat përballen fermerët e vegjël dhe në këtë mënyrë i trajtojnë në mënyrë të pabarabartë. Përjashtimi nga pagesat direkte në një kohë kur nuk ofrohen mbështetje alternative është tepër serioze. Fryma e PBB është që të gjithë fermerët të trajtohen në mënyrë të barabartë duke zbatuar parimin e kushteve të barabarta konkurruese. Edhe pse vlerësohet kontributi i fermerëve të mëdhenj në ekonominë e vendit dhe arritjen e standarteve, është kritike krijimi i skemave mbështetëse për fermerët e vegjël. Mbështetja e bujqësisë duhet të ndahet në mënyrë të barabartë dhe të drejtë.

Zonat rurale malore dhe të largëta ende nuk janë target i masave specifike të mbështetjes buxhetore. Edhe Agjensia e Zhvillimit të Zonave Malore që kishte në fokus pikërisht zhvillimin e këtyre zonave, u mbyll vitet e fundit. Duke risjellë në vëmendje se zonat malore kanë tregues të varfërisë shumë të lartë krahasuar me zonat bregdetare dhe ato qendrore të vendit, ato duhet të jenë në fokus të politikave të sektorit për t'iu ofruar banorëve në këto zona mbështetje për të qëndruar dhe vazhduar sipërmarrjet dhe angazhimet e tyre ekonomike. Mbështetja financiare e zonave më pak të favorizuara në BE përfaqëson një masë të rëndësishme. Në përgatitjet e vendit tonë për integrimin në BE, zonat malore duhet të risillen në qendër të politikave të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Gjithashtu, mbështetja buxhetore ka qenë e orientuar drejt masave tipike bujqësore, dhe **kanë munguar dukshëm masat për zhvillimin e ekonomisë dhe jetës rurale.** Mungesa e politikave të zhvillimit rural përbën edhe një nga boshllëqet në pajtueshmërinë me PBB. Politikat e zhvillimit rural ende nuk janë të qarta, pavarësisht ndërmarrjes së programeve të ndryshme siç është ai i 100 fshatrave. Ende zbatimi i qasjes Leader nuk është pjesë e mbështetjes buxhetore, edhe pse tejkalon çdo afat kohor të përcaktuar në Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (2014- 2020) për zbatimin e saj. Në këtë aspekt, Shqipëria mbetet prapa vendeve të rajonit përse i përket promovimit të kësaj qasje si instrument të PPB për zhvillimin e integruar të komuniteteve rurale. Përpjekje të tilla të munguara do të lehtësonin përthithjen e fondeve nga IPARD II për masën e qasjes LEADER. Përtej kësaj, zonave rurale do t'u prezantohej një filozofi e zhvillimit të qëndrueshëm që mbart potencialin e adresimit të problematikave që për vite të tëra dështojnë të zgjidhen nga politikat publike.

Programi IPARD II, i lancuar me të drejtë si dritarja e madhe e financimit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, **duket se ka pak gjasa për të qenë një sipërmarrje e suksesshme.** Kjo bazuar kryesisht në shqetësimet legjitime të aktorëve vendor, ndër të tjera ato të lidhura me çështjen e pronësisë së tokës, mungesën e kapaciteteve për përgatitjen e projekteve të suksesshme, kriterëve të paarrtshme për pjesën më të madhe të fermerëve, mungesën e besimit të institucionet, etj. Gjithashtu, ka mungesë të mëdha të informacionit rreth IPARD II në pjesën më të madhe të fermerëve por edhe të aktorëve të tjerë vendor. Një tour informimi në kohën e hapjes së thirrjeve të para për projekte është përpjekje e pamjaftueshme. Institucionet qendrore, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) dhe Agjensia e Zhvillimit Bujqësor dhe



Rural (AZHBR) kanë reflektuar dobësi dhe nuk kanë adresuar në kohë kapacitetet e mangëta vendore duke e kthyer varësinë nga qendra zgjidhjen e momentit. Në një kohë kur thirrjet e IPARD II bazohen në ndërtim dhe rindërtim, një pjesë e mirë e komuniteteve rurale ndjehen të përjashtuar, për shkak të mungesës së certifikatave të pronësisë. Që IPARD II të rezultojë i suksesshëm, duhet që të mbështetet nga politika pro-aktive në lidhje me pronësinë e tokës për të lejuar fermerë e sipërmarrës potencial të zhvillojnë tokën për të ndërtuar, rindërtuar, zgjeruar fermën etj.


Mungesa e sistemeve të qëndrueshme të konsultimit ndërmjet hartuesve të politikave dhe grupeve të ndryshëm të interesit, u identifikua njëzëri nga katër forumet rajonale. Njohja dhe të kuptuarit e interesave, problemeve dhe prioritetëve që kanë komunitetet rurale, në dukje një process i thjeshtë, rezulton i vështirë dhe i perealizueshëm nga vendimarrësit. Një njohje e mirë e problemeve dhe nevojave të zonave rurale do të ndihmonte në zgjedhjen e instrumenteve dhe masave që janë efektive.

Politikat bujqësore dhe rurale nuk kanë mundur të fuqizojnë parimin e subsidiaritetit – **forcimin e rolit të bashkive si qeverisja më pranë qytetarëve që njeh mirë problemet dhe potencialet e territoreve vendore dhe harmonizon politikat kombëtare me prioritetet zhvillimore vendore.**

Hartimi dhe zbatimi i skemave kombëtare të mbështetjes, IPARD II, programit të 100 fshatrave dhe çdo inisiativë tjetër ka potencial të maksimizohet dhe të jetë efikase nëse mbështeten në bashkëpunimin e ngushtë me qeverisjen lokale. Roli aktiv i bashkive në procesin e hartimit, zbatimit dhe vendim-marrjes në politikat bujqësore është domosdoshmëri, po aq sa edhe forcimi i kapaciteteve teknike të stafit vendor.

Transparenca - një nevojë sa institucionale aq edhe dimension kritik për ndërvëprimin si dhe krijimin dhe mbajtjen e besimit të fermerëve dhe aktorëve të tjerë të insitucionet publike – përfaqëson shqetësimin kryesor të përbashkët të katër forumeve. Mungesa e informacionit në lidhje me përfituesit e skemave, masën e përfitimit, arsyet e përfitimit apo mospërfitimit apo informacione jo të sakta në lidhje me statusin e aplikimit si dhe burokracitë e shumta kanë shkaktuar pakënaqësi dhe uljen e besimit të fermerëve dhe sipërmarrësve të institucionet përgjegjëse publike. Vonesa të gjata në pagesa, reduktime të masës së përfitimit, apo edhe mungesën e pagesave për fermerët fitues me justifikime jo-logjike kanë dobësuar besimin e fermerëve jo vetëm në skemat kombëtare, por edhe të IPARD II. Për fermerët, pavarësisht burimeve financiare, institucionet zbatuese mbeten të njëjta.

Reforma në politikat bujqësore të domosdoshme në procesin e integritit european kërkon **forcimin e kapaciteteve administrative dhe institucionale për të zbatuar me sukses politikat bujqësore përputhshmërisht me PPB.** Sistemi i identifikimit të parcelave të tokës (SIPT), Sistemi i Integruar Administrativ dhe i Kontrollit (SIK) si dhe Rrjeti i të dhënave mbi llogaritë e fermës mbetën boshllëqet kryesore në




këtë drejtim.¹⁰ Këto sisteme do të mundësonin përdorimin me efikasitet të fondeve të mbështetjes.

Programi i 100 fshatrave që fillimisht nxiti besimin e aktorëve në potencialet e zhvillimit bujqësor dhe rural, rrugës nuk mundi të mobilizonte burimet njerëzore dhe të animojë aktorët (qeverisje vendore, shoqëri civile, biznesi, etj), çka do të forconte pronësinë e aktorëve vendor dhe përshpejtonte ritmet drejt zhvillimit të qëndrueshëm të zonave rurale.

Procesi konsultues mundësoi njohjen me shumë çështje të tjera të drejta dhe legjitime, marrja në konsideratë e të cilave nga vendimarrësit do të rezultonte në politika më efektive për fermerët dhe sipërmarrësit. Është kritike lehtësimi i aksesit të fermerëve në skemat e mbështetjes. Nëse jo të gjithë përfitojnë, aksesit në informacion dhe mbi procesin e aplikimit i duhet mundësuar çdo fermeri. Ofrimi në kohë i informacionit në mënyrë të plotë, të qartë dhe të kuptueshme, dhënia e asistencës në sigurimin e dokumentave, lehtësimi i procesit të aplikimit, reduktimi i burokracisë etj., do të ishin mjaft ndihmuese.

Gjithashtu, për të rritur mundësitë e një numri më të madh fermerësh për të aplikuar dhe përfituar në skemat kombëtare të mbështetjes do të ndihmonte një proces aplikimi i hapur, pa afate të ngurta. Koherenca mes dy cikleve – ciklit të skemave me aktivitetin bujqësor e blegtoral - veçanërisht për ato masa që lidhen me mbështetjen e prodhimit do të përputhte mbështetjen publike me nevojën reale të fermerëve. Është e domosdoshme përzgjedhja e masave të mbështetjes bazuar në studime dhe konsultime të gjera me grupet e interesit si dhe kryerja e vlerësimeve për efikasitetin e tyre. Studimet duhet të përfshijnë edhe çështjen e çmimeve dhe koston e inputeve si një mënyrë për të përcaktuar nivele inkurajuese të përfitimit financiar bazuar në çmime reale të tregut. Etj.

10 Komisioni European (2018), Raporti për Shqipërinë 2018. (Strasburg, 17.4.2018) <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>





Rekomandime

Rekomandimet e mëposhtme lidhen me vizionin tone për të ndërruar kahun e proceseve që po kthejnë fshatra të shumtë nga realitete vendore në thjesht nocione gjeografike. Ngadalësimi i ritmit të këtyre proceseve duhet të jetë objektiv prioritar afat-shkurtër për qeverisjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

1

Politikat zhvillimore të sektorit duhet të jenë afatgjata, të adresojnë sfidat zhvillimore të bujqësisë dhe zhvillimit rural dhe reflektojnë prioritetet dhe interesat e fermerëve dhe sipërmarrësve duke iu larguar agjendave dhe pragmatizmit politik. Politikat dhe instrumentet duhet të jenë të qëndrueshme, me mbështetje buxhetore më të madhe dhe lehtësisht të aksesueshme nga shumica e fermerëve.

2

Angazhimi politik për t'u integruar në BE ka nevojë të reflektohet **në zbatimin e reformave të politikës bujqësore në përputhje me PPB**. Ngritja e kapaciteteve administrative dhe institucionale si dhe zgjidhja e problemeve të pronësisë së tokës kërkon vëmendje të veçantë për të bërë të efektshme fondet e asistencës së paraaderimit.

3

Reduktimi i distancës së pushtetit me komunitetet nëpërmjet **proceseve vendim-marrëse me pjesëmarrje, transparente është kritike për të rritur efektivitetin e politikave publike dhe besimin te institucionet publike**. Informimi publik dhe transparenca duhet të jenë në themel të çfarëdo mbështetje dhe incentiveve publik për sektorin. Forumet e Drinit, Arbërit, Egnatias dhe Vjosës i vinë në ndihmë proceseve të tilla.

4

Fermerët e vegjël duhet të jenë në qendër të politikave dhe instrumenteve mbështetës të sektorit të cilati trajtojnë në mënyrë të barabartë dhe të drejtë me të tjerët. Masa për zinxhirët ushqimorë mund të promovohen për fermat e vogla.

5

Politikat duhet të kontribuojnë në reduktimin e pabarazive zhvillimore për të siguruar kohezion social-ekonomik. Zonat e pazhvilluara duhet të targetohen nga politikat e sektorit me instrumente mbështetës konkrete efikase.

6

Së fundmi, si pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme advokuese të ANRD, risjellim në vëmendje **domosdoshmërinë e zbatimit të qasjes LEADER/ CLLD** jo vetëm si detyrim në kuadër të IPARD II, por mbi të gjitha si një investim për një zhvillim të qëndrueshëm të vendit dhe forcimin e demokracisë vendore. Zbatimi i qasjes LEADER është një proces afatgjatë, ndaj MZHBR si institucioni kryesor duhet të mundësojë nisjen e një procesi animues kombëtar¹¹. Miratimi i kuadrit rregullator për funksionimin e Grupeve Lokale të Veprimit (GLV) duhet të finalizohet.

11 Hroni, S., Azizaj, E. (2018) Qasja Leader dhe Programi i 100 fshatrave. Një perspektivë plotësuese dhe sinergjike për zhvillimin e integruar të zonave rurale. Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural.